



UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
"ISA BOLETINI"

Rruga Ukshin Kovaqica, Republika e Kosovës
http/www.umib.net; Tel: +381-28535725/535727

Kryesues i Senatit
Prof. dr. Alush Musaj

Nr. Prot. 507/004
Dt 27.03.2019

Senati i Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", bazuar në rekomandimin e ekspertëve të jashtëm gjatë akreditimit në vitin 2017, në mbledhjen e mbajtur më 19.03.2019, mori:

VENDIM

- I. Aprovohet Plani i zhvillimit të personelit akademik në UMIB për periudhën 2019-2021.
- II. Këtij vendimi i bashkëngjitet Plani i zhvillimit të personelit akademik në UMIB për periudhën 2019-2021.

Arsyetim

Gjatë akreditimit institucional dhe të programeve të studimit, ekspertët e jashtëm në vitin 2017, në mes tjerash kanë rekomanduar edhe hartimin e një plani për zhvillimin e personelit akademik. Për të zbatuar këtë rekomandim dhe për të përmbushur një detyrë institucionale që personelit akademik t'i krijohen kushtet e nevojshme për hulumtim dhe zhvillim, Senati i UMIB dhe menaxhmenti nëpërmes punës ekipore kanë hartuar këtë plan. Bazuar në këto që u cekën si më lartë, Senati mori vendim si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi t'i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB-it;
2. Fakulteteve;



Prof. dr. Alush Musaj

Rektor i UMIB-it



Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini”

Senati i Universitetit

**PLANI PËR ZHVILLIMIN E PERSONELIT
AKADEMIK
2019-2021**

Mitrovicë, mars 2019

Përmbajtja:

HYRJE 3

OBJEKTIVI STRATEGJIK:

1. ZHVILLIMI DHE AVANCIMI I PERSONELIT AKADEMIK 4

Objektivat specifike:

1.1. Personel i ri cilësor që do të zhvillohet për nevojat e Fakulteteve 4
1.2. Përtëritja dhe kualifikimi i personelit akademik 4
1.3. Aftësimi i vazhdueshëm i personelit akademik në fushën e metodologjisë së mësimdhënies 5
1.4. Pjesëmarrja e rregullt e personelit akademik në konferenca, seminare, simpoziume apo tubime tjera shkencore ndërkombëtare..... 5
1.5. Përkrahja e vazhdueshme e personelit akademik për avancim akademik..... 5

OBJEKTIVI STRATEGJIK:

2. MBËSHTETJA E PERSONELIT AKADEMIK NË HULUMTIME SHKENCORE 6

Objektivat specifike:

2.1. Zhvillim më i theksuar i hulumtimit shkencor në proporcion me mësimdhënien 6
2.2. Përkrahja e personelit akademik për të publikuar në revista me recension ndërkombëtar 6
2.3. Sigurimi i qasjes në revista shkencore elektronike dhe organizata shkencore ndërkombëtare 6
2.4. Përkrahja dhe motivimi i personelit akademik për inicim dhe pjesëmarrje në projekte ndërkombëtare6
2.5. Themelimi i revistës shkencore..... 7
2.6. Organizmi i konferencave shkencore..... 7

OBJEKTIVI STRATEGJIK:

3. MBËSHTETJA E PERSONELIT AKADEMIK NË BOTIMIN E PUBLIKIMEVE 7

4. ZBATIMI I PLANIT TË ZHVILLIMIT 8

HYRJE

Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini” (në vazhdim UMIB) është themeluar me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës më 06.03.2013 dhe në kuadër të Universitetit janë përfshirë edhe dy njësitë akademike të UP-së me seli në Mitrovicë – Fakulteti i Gjeoshkencave dhe Teknologjisë (*ish Fakulteti i Xehetarisë dhe Metalurgjisë*) dhe Fakulteti i Shkencave të Aplikuara (*ish Fakulteti i Shkencave Teknike të Aplikuara dhe ish Shkolla e Lartë Teknike*). Universiteti është themeluar që të ofrojë arsimim akademik, kërkime shkencore dhe krijimtari artistike. UMIB bazuar në Statutin e Përkohshëm është institucion autonom i arsimit të lartë, që zhvillon arsimim akademik, kërkime shkencore, krijimtari artistike, këshillime profesionale dhe fusha të tjera të veprimtarive akademike. Andaj funksionalizimi i UMIB-it është bërë duke u mbështetur në fakultetet e trashëguara dhe të riorganizuar, dhe në përgjithësi për gjashtë fakultetet që tani janë të organizuara në kuadër të UMIB-it: Fakulteti i Gjeoshkencave; Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore; Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike; Fakulteti Juridik; Fakulteti Ekonomik dhe Fakulteti i Edukimit. Përveç numrit të personelit akademik të trashëguar nga dy ish fakultetet e UP – së, gjithsejtë 71 personel akademike, kryesisht të fushave teknike (Teknologji; Inxhinieri dhe Teknologji Ushqimore; Xehetari; Gjeologji; Materiale dhe Metalurgji; Makineri; Inxhinieri Informatike), UMIB në vazhdimësi është duke u konsoliduar me personel akademik për të siguruar mësimdhënie cilësore dhe për të plotësuar standardin e nevojshëm të personelit. Në fazën e parë të zhvillimit, brenda dy viteve pas themelimit respektivisht ekzistimit, UMIB, përveç numrit solid të personelit në fushat e lartcekura, ka siguruar minimumin e personelit akademik edhe në fakultetet e reja, të themeluara në vitin 2014 dhe atë: Fakulteti Juridik; Fakulteti i Edukimit dhe Fakulteti Ekonomik. Përveç këtij numri solid thuaja të mjaftueshëm në fakultetet teknike dhe minimumit të mirë në fakultetet tjera dhe që kërkon zhvillim të vazhdueshëm, personeli akademik duhet të mbështetet në vazhdimësi dhe kërkon kushte optimale për një punë shkencore dhe pedagogjike.

Gjatë akreditimit institucional dhe të programeve të studimit, ekspertët e jashtëm në vitin 2017, në mes tjerash kanë rekomanduar edhe hartimin e një plani për zhvillimin e personelit akademik. Për të zbatuar këtë rekomandim dhe për të përmbushur një detyrë institucionale që personelit akademik ti krijohen kushtet e nevojshme për hulumtim dhe zhvillim, Senati i UMIB dhe menagjimenti nëpërmes punës ekipe kanë hartuar këtë plan.

Avancimi i personelit akademik nuk do të mund të paramendohej pa një numër të caktuar publikimesh dhe citimesh nga të tjerët në një fushë të caktuar të studimit. UMIB dhe njësitë akademike në kuadër të saj janë duke punuar me përkushtim që të sigurojnë ngritje kualitative, arsimore – profesionale dhe shkencore në fushat të cilat studiohen në UMIB. Andaj, mësimdhënia dhe mësim nxënia respektivisht ndërlihdja e punës kërkimore me mësimdhënien janë proces i pandarë në mënyrë që të sigurohet ngritja e cilësisë. Është pikërisht komponenti shkencore që i dallon institucionet akademike nga institucionet e tjera profesionale. Në institucionet e avancuara të arsimit të lartë hulumtimi paraqet fushë të veprimtarisë së përditshme të mësimdhënësve dhe në të cilën investohet shumë.

Plani për zhvillimin e personelit akademik, është dokument që personelit akademik i siguron kushte modeste për zhvillim, avancim dhe promovim akademik. Zbatimi i plotë i këtij plani, stimulon personelin për tu marrë me veprimtari kërkimore shkencore, duke publikuar në revista shkencore ndërkombëtare, për të marrë pjesë në konferenca shkencore, për të arritur gradat shkencore dhe titujt akademik, si dhe përgatitjen e botimeve për të pasuruar krijimtarinë shkencore dhe për të mbuluar fushat studimore në kuadër të fushave ku nuk ka literaturë të mjaftueshme. Plani për zhvillimin e personelit akademik i

dedikohet personelit akademik në marrëdhënie të rregullt pune në fakultetet e UMIB – it, me qëllim të zhvillimit dhe avancimit të mësimdhënësve në pjesën hulumtuese dhe pedagogjike, që programeve të studimit ti sigurohet funksionim cilësor akademik. Plani për zhvillimin e personelit akademik mbështetet në tri objektiva strategjike, të zërthyer në objektiva specifike, si dhe aktivitetet për arritjen e këtyre objektivave. Objektivat strategjike ku mbështetet plani për zhvillimin e personelit akademik janë:

1. Zhvillimi dhe avancimi i personelit akademik;
2. Mbështetja e personelit akademik në hulumtime shkencore dhe
3. Mbështetja e personelit akademik në botimin e publikimeve.

1. OBJEKTIVI STRATEGJIK: ZHVILLIMI DHE AVANCIMI I PERSONELIT AKADEMIK

1.1. Objektivi specifik: Personel i ri cilësor që do të zhvillohet për nevojat e fakulteteve

Aktivitetet konkrete për realizimin e objektivave:

- 1.1.1. Ashtu siç parashihet me Statutin e UMIB – it, Universiteti do të krijoj mundësi të barabarta gjatë rekrutimit të personelit të ri akademik, duke siguruar dhe mbështetë barazinë gjinore dhe duke promovuar dhe krijuar mundësi të ngritjes së pjesëmarrjes së gjinisë femërore në përbërjen e personelit akademik.
- 1.1.2. Personelit akademik do t'i ofrohet mundësi e plotë që ti kryejë detyrat dhe përgjegjësitë e veta nga mësimdhënia, hulumtimi, mobiliteti etj.
- 1.1.3. Do të sigurohet dhe promovohet liria akademike, si një e drejtë themelore kushtetuese e garantuar.
- 1.1.4. Do të sigurohet vazhdimisht personel akademik i kualifikuar sipas fushës përkatëse për programet mësimore që ofrohen në kuadër të fakulteteve, duke përfshirë këtu edhe fushat e ngushta profesionale.
- 1.1.5. Do të krijohen kushte dhe përkrahje institucionale për avancim dhe kualifikim të personelit akademik të ri për hulumtim dhe mësimdhënie cilësore. Do të sigurohen shërbime cilësore dhe mbështetje administrative efikase.

1.2. Objektivi specifik: Përtëritja dhe kualifikimi i personelit akademik

Aktivitetet konkrete për realizimin e objektivave:

- 1.2.1. Me qëllim të arritjes të kualifikimeve përkatëse, personeli akademik do të përkrahet në realizimin e mobilitetit shkencor pranë universiteteve ndërkombëtare, ose ndonjë formë tjetër e stimulimit, në mënyrë që ata të merren me punë kërkimore-shkencore. Për të arritur këto qëllime personelit akademik do t'i mundësohet pushim me pagesë.
- 1.2.2. Do të zhvillohen procedura që rrisin cilësinë dhe kapacitetet për realizimin e punës kërkimore shkencore. Këto procedura do të përcaktojnë fushat me interes për realizimin e mobilitetit shkencorë, krijimin e rrjeteve të bashkëpunimit ndërkombëtar në projekte dhe publikime, përkrahjen materiale si dhe promovimin në zhvillimin e mëtutjeshëm të

imazhit të UMIB – it. Do të mbështeten mobilitetet e mundshme të personelit mësimdhënës, për qëndrime semestrale ose vjetore me qëllim të ngritjes së tyre shkencore dhe profesionale.

1.3. Objektivi specifik: Aftësimi i vazhdueshëm i personelit akademik në fushën e metodologjisë së mësimdhënies

Aktivitetet konkrete për realizimin e objektivave:

- 1.3.1. Universiteti do të krijoj kushte që grupe të mësimdhënësve dhe asistentëve të dërgoj jashtë vendit për ngritje profesionale dhe për çështje bashkëkohore të metodologjisë së mësimdhënies.
- 1.3.2. Universiteti do të krijoj kushte që të organizoj trajnime duke angazhuar ekspertë nga jashtë. Ky aktivitet do t'i përfshinte kryesisht mësimdhënësit dhe asistentët e rinj.
- 1.3.3. Çdo vit do të mundësohet dhe përkrahet personeli akademik të vijoje programet e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Qendrës për përsosmëri në mësimdhënie të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", në kuadër të marrëveshjes për bashkëpunim ndërmjet dy universiteteve. Këto programe dhe trajnime kanë për qëllim zhvillimin e njohurive dhe praktikave të reja të mësimdhënies.

1.4. Objektivi specifik: Pjesëmarrja e rregullt e personelit akademik në konferenca, seminare, simpoziume apo tubime tjera shkencore ndërkombëtare

Aktivitetet konkrete për realizimin e objektivave:

- 1.4.1. Do të mbështetet personeli akademik për pjesëmarrje në konferenca, seminare, simpoziume apo tubime tjera shkencore ndërkombëtare.
- 1.4.2. Personeli akademik do të përkrahet dhe stimulohet që vazhdimisht të paraqitet në konferenca dhe simpoziume shkencore, qofshin ato ndërkombëtare, rajonale, apo nacionale, ku do të paraqiten prezantimet shkencore.
- 1.4.3. Për qëllim të pjesëmarrjes në konferenca ose simpoziume shkencore, në kuadër të mundësive buxhetore, personeli akademik do të mbështetet materialisht.

1.5. Objektivi specifik: Përkrahja e vazhdueshme e personelit akademik për avancim akademik

Aktivitetet konkrete për realizimin e objektivave:

- 1.5.1. Universiteti, do të përkrahë personelin akademik që e ka gradën shkencore Master, për avancim akademik për të arritur gradën PhD.
- 1.5.2. Do të krijohen kushte për mobilitete afatshkurtra, përfshirë këtu vizitat studimore në institucione akademike dhe hulumtuese ndërkombëtare.

2. OBJEKTIVI STRATEGJIK: MBËSHTETJA E PERSONELIT AKADEMIK NË HULUMTIME SHKENCORE

2.1. Objektivi specifik: Zhvillimi më i theksuar i hulumtimit shkencor në proporcion me mësimdhënien

Aktivitetet konkrete për realizimin e objektivave:

- 2.1.1. Krijimi i kushteve për angazhimin e personelit akademik të UMIB në mësimdhënie dhe veprimtari kërkimore shkencore bazuar në praktikatat më të mira evropiane.
- 2.1.2. Krijimi i mundësive për botimin e punimeve shkencore të personelit mësimdhënës në revista me recension ndërkombëtar.
- 2.1.3. Personeli akademik duhet të aftësohet për të hartuar projekte të bashkëpunimit për hulumtim dhe bashkëpunim me partnerë vendorë dhe ndërkombëtarë.
- 2.1.4. Do të rritet bashkëpunimi institucional ndërkombëtar në fushën e kërkimeve shkencore.
- 2.1.5. Do të krijohet mundësi për qasje më të gjerë të personelit akademik dhe të studentëve në burime elektronike, me qëllim të përcjelljes së zhvillimeve më të reja shkencore.

2.2. Objektivi specifik: Përkrahja e personelit akademik për të publikuar në revista me recension ndërkombëtar

Aktivitetet konkrete për realizimin e objektivave:

- 2.2.1. Personeli akademik vazhdimisht do të përkrahet, në mënyrë që ata t'i publikojnë punimet e tyre shkencore në revista shkencore, në pajtim me platformat e miratuara nga MASHT – i, Senati dhe këshillat e fakulteteve.
- 2.2.2. Personeli akademik do të mbështeten në iniciimin e ideve të tyre për publikime cilësore në revista shkencore.

2.3. Objektivi specifik: Sigurimi i qasjes në revista shkencore elektronike dhe organizata shkencore ndërkombëtare

Aktivitetet konkrete për realizimin e objektivave:

- 2.3.1. Do të mundësohet parapagimi në pako elektronike ndërkombëtare shkencore, për t'i ndihmuar personelit akademik rritje të numrit të publikimeve në revista ndërkombëtare.
- 2.3.2. Do të përkrahet anëtarësimi dhe do të parapagohen kërkesat eventuale financiare për qasje në asociacionet, rrjetet e bashkëpunimit, institutet dhe organizatat e tjera shkencore ndërkombëtare, ku stafi akademik do të mund të përfitojë nga mundësitë që ofrojnë këto organizata.

2.4. Objektivi specifik: Përkrahja dhe motivimi i personelit akademik për inicim dhe pjesëmarrje në projekte ndërkombëtare

Aktivitetet konkrete për realizimin e objektivave:

- 2.4.1. Do të mundësohet pjesëmarrja e personelit akademik në trajnime dhe seminare të ndryshme me qëllim të aftësimin të tyre në hartimin e projekteve dhe të propozimeve për pjesëmarrje në programet e ndryshme kërkimore të BE – së dhe në krijimin e lidhjeve me institucionet kërkimore ndërkombëtare.
- 2.4.2. Organizimi i punëtorive me qëllim që t'u ndihmojë personelit akademik që sa më lehtë dhe në mënyrë efikase të ndërliken me projektet e ofruara ndërkombëtare për bashkëpunim.

2.4.3. Nëse ndonjë nga këto projekte implementohet në partneritet me institucione të tjera, UMIB do të bëjë përpjekje maksimale për të ofruar kushte optimale për zhvillim të bashkëpunimit.

2.5. Objektivi specifik: Themelimi i revistave shkencore

Aktivitetet konkrete për realizimin e objektivave:

2.5.1. Senati do të themelojë revistë shkencore ku do të publikohen punimet shkencore të personelit akademik dhe komunitetit të gjerë shkencorë. Mënyra e funksionimit të revistës, do të rregullohet më hollësisht me akt të veçantë nga ana e Senatit.

2.5.2. UMIB do të mbështesë publikimin e numrave të revistës.

2.5.3. Pas botimit të numrit të parë, UMIB do të aplikojë për akreditim ndërkombëtar të revistës.

2.5.4. Në kuadër të fakulteteve mund të themelohen revista shkencore edhe nga fusha të ngushta të studimit.

2.6. Objektivi specifik: Organizimi i konferencave shkencore

Aktivitetet konkrete për realizimin e objektivave:

2.6.1. Do të mbështeten dhe inkurajohen organizimet e konferencave shkencore ku organizator, apo bashkë organizatorë do të jetë UMIB.

3. OBJEKTIVI STRATEGJIK: MBËSHTETJA E PERSONELIT AKADEMIK NË BOTIMIN E PUBLIKIMEVE

Aktivitetet konkrete për realizimin e objektivave:

3.1. Do të mbështeten botimet e teksteve, praktikumeve, përmbledhjeve të punimeve dhe teksteve të tjera, të cilat përmbajnë arritjet profesionale apo shkencore nga personeli akademik.

3.2. Përparësi botimi kanë publikimet origjinale, sidomos për lëndët mësimore që nuk kanë tekst bazë universitar dhe publikimet të cilat me plane dhe programe mësimore janë literaturë e domosdoshme për studentë.

3.3. Publikimet e botuara do të shfrytëzohen për nevoja të studentëve, personelit dhe komunitetit të gjerë shkencorë.

3.4. Kushtet dhe procedurat për dorëzimin e dorëshkrimit, mbështetjen financiare dhe aspektet e tjera, janë të rregulluara me Rregulloren për publikimet në UMIB të nxjerr nga Senati.